



## Niveli Vendor në një Vështrim SHQIPËRIA

**FIER**

**Qershor 2020**

Në shkurt të vitit 2018 u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit si një marrëveshje trepalëshe midis Këshillit të Evropës, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Fier. U caktua një pikë kontakti e bashkisë për programin ROMACTED nga Kryetari i bashkisë për të ofruar mbështetje dhe për të lehtësuar procesin e zbatimit të programit në nivel bashkie.

Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2018, në Fier u ngritën zyrtarisht Grupi Komunitar i Veprimit (GKV), Grupi Institucional i Punës (GIP) dhe Grupi i Task-Forcës së Bashkisë (GTB).

Përmes Programit ROMACTED është arritur të krijohet dhe të zhvillohet një komunikim efikas mes institucioneve vendore dhe komuniteteve rome, si dhe është rritur llogaridhënia e autoriteteve vendore në raport me romët, si dhe nevojës për integrimin e tyre social dhe respektim të të drejtave të njeriut.

## Arritjet kryesore

### DOKUMENTET VENDORE TË PËRGATITURA NË KUADRIN E ROMACTED



- Sondazhi për situatën bazë dhe kriteret përzgjedhëse të bashkisë;
- Vlerësimi i Kapaciteteve të Bashkisë - informacione të mbledhura për nevoja të administratës vendore për t'iu përgjigjur si duhet nevojave të komunitetit;
- Vlerësimi i Nevojave në Nivel Komuniteti - identifikimi dhe njohja e karakteristikave të komunitetit rom, nevojave, mundësive dhe kërkesave të tyre;
- Hartëzimi i Aktorëve të Interesuar - identifikimi i aktorëve të interesuar të të gjitha niveleve me qëllim krijimin e strukturave dhe sinergjive vendore;
- Hartimi i Listës së Prioriteteve të Komunitetit - janë identifikuar gjithashtu masat, mënyrat dhe aktorët, që kontribuojnë në arritjen e përbushjes së nevojave kryesore;
- Hartimi i Planit Vendor të Veprimit - përkthimi i nevojave në aktivitete afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të dakordësuara mes anëtarëve të Grupit të Task Forcës së Bashkisë;
- Llogaritja e kostove të aktiviteteve të Planit Vendor të Veprimit - duke marrë parasysh afate të parashikuara, numrin e aktiviteteve dhe numrin e përfituesve, gjë që ndihmon autoritetet vendore në planifikimin e buxhetit vjetor dhe në buxhetimin afatmesëm;
- **Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022**, miratuar nga Këshilli i Bashkisë Fier me vendimin nr. 73, datë 18 qershor 2019.

### NGRITJA E KAPACITETEVE



Tre anëtarë të GVK dhe dy anëtarë të GIP u trajnuan për "Planifikimin Strategjik Vendor me Pjesëmarrje" gjatë vitit 2018 dhe për "Hartimin e Planeve të Përbashkëta të Veprimit për Integrimin e Romëve në nivel vendor" gjatë vitit 2019. Gjatë vitit 2020 u trajnuan nëntë pjesëmarrës të Task Forcës së Bashkisë për "Buxhetimi me përgjigjshmëri rome në nivel vendor".

## STREHIMI DHE INFRASTRUKTURA

- 49 familje rome u informuan dhe u udhëzuan nga Bashkia e Fierit për Programin ROMACTED për përgatitjen dhe hartimin e planit të shtëpisë. Ky projekt iu paraqit Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për mbështetje dhe financim nga Bashkia Fier;
- U ndihmuan 40 familje rome për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për legalizimin e tokës së tyre bujqësore. Ky dokumentacion iu paraqit Agjencisë për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Zonave dhe Ndërtimeve Informale (ALUIZNI);
- Në bazë të kërkesave të Bashkisë Fier, u krijua një bazë të dhënash me 220 familje rome të pastreha për ofrimin e restaurimit të shtëpive dhe për strehimin e të pastrehëve;
- 19 familje nga Mbrostari morën certifikatat e legalizimit. Kjo u mundësua falë bashkëpunimit mes Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave Durrës dhe Agjencisë për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Zonave dhe Ndërtimeve Informale të Fierit;
- Katër familje nga Driza morën certifikatat e legalizimit.



## PUNËSIMI DHE FORMIMI PROFESIONAL



- U punësuan 37 romë në sektorë të ndryshëm (15 gra rome nga Baltëza në punë bujqësore sezonale, katër të rinj nga Driza në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, si dhe 18 persona nga Driza, Levan dhe Baltëz në një fabrikë këpucësh në Vlorë). Punësimi i tyre u arrit përmes informimit të komunitetit për vendet vakante dhe ndërmjetësimin me biznese, si dhe mes bashkëpunimit me Zyrën e Punës Fier.
- Shtatë gra rome u punësuan me kohë të plotë në një fabrikë këpucësh në Drizë;
- 48 të rinj romë u regjistruan në kurse profesionale (për hidraulikë, shtrim pllakash, saldatorë, rrobaqepës dhe parukiere). Të regjistruar fillimisht si punëkërkues në Zyrën e Punës, ata u regjistruan më pas në Qendrën e Formimit Profesional.
- 18 të rinj romë u regjistruan në kurse në "Qendrën e Kurseve Profesionale Agroni" për aftësi të ndryshme profesionale (tre berberë, një prodhues lopatash, pesë hidraulikë, tre saldatorë, dy për kurs IT, një për konfeksione, një rrobaqepës dhe dy në kurs për shtrim pllakash);
- 46 romë morën mbështetje në regjistrimin në Zyrën e Punës si punëkërkues;
- Pesë romë u punësuan në kompaninë Jura, që prodhon pajisje për procese të ndryshme pune në bazë të aftësive të tyre.

## ARSIMI DHE DIALOGU NDËRKULTUROR

- 184 fëmijë u regjistruan në kopsht dhe në këto shkolla: shkollat e mëposhtme: "Trifon Pifti (Baltëz)"; "Kostandin Dino (Levan)"; "Halit Gremi (Mbrostar)"; "Kostandin Peto (Fermë Clirimi)"; "100 vjetori i Pavarësisë (Drizë)"; dhe "Llukan Sako (Sektori Seman)";
- 136 nxënës morën libra shkollorë falas në këto shkolla: "100 vjetori i pavarësisë Drizë"; "Kostandin Dino Levan" dhe "Halit Gremi Mbrostar Ura";
- Nëntë fëmijë morën çanta shkolle në Sektor Seman falë ndërmjetësimin me Nismën për Ndryshim Social - Arsis;



## ARSIMI DHE DIALOGU NDËRKULTUROR




- Këshillat e prindërve u mbështetën në shkollat e Sektor Seman përmes një seance informimi për rregullat, të drejtat, rolet dhe detyrat e tyre. Kjo çoi në rritjen e pjesëmarrjes dhe angazhimit të prindërve në shkolla në lidhje me performancën e fëmijëve të tyre, si dhe në promovimin e rëndësisë së arsimit për nxënësit;
- Më 5 prill 2018, grupi artistik në bashkinë Fier nga Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA) performoi dramën "Ena e Drunjtë", e cila pati për qëllim promovimin e rëndësisë së fuqizimit të komuniteteve rome për integrimin e tyre në nivel vendor dhe përkujtimin e 8 prillit përmes festimit të kulturës rome. Ekipi performues përbëhej dhe drejtohej nga talente rome, të cilët demonstuan aftësitë e tyre artistike, duke rritur ndërgjegjësimin për çështjet rome përmes artit dhe kulturës.

## AKSESI NË SHËRBIMET SHËNDETËSORE

- U vaksinuan 16 fëmijë (3-6 vjeç) dhe 39 fëmijë (6-14 vjeç);
- Morën mbështetje për realizimin e kontrolleve të përgjithshme mjekësore 14 gra rome dhe nëntë burra romë;
- 18 gra rome morën pjesë në seancat e informimit për vaksinimin dhe ushqyerjen e fëmijëve, të cilat u organizuan nga koordinatorët në bashkëpunim me qendrat shëndetësore;
- GKV-ja doli me një kërkesë urgjente për pastrimin e zonave të kontaminuara në Drizë, të cilat rrezikojnë shëndetin e komunitetit rom që jeton atje. Më pas u pastruan zonat e kontaminuara, një veprim i kryer në bashkëpunim me Drejtorinë e Gjelbërimit të Bashkisë Fier.



## REGJISTRIMI NË GJENDJEN CIVILE



Shtatë individë romë u mbështetën me dokumentacion për regjistrimin në gjendjen civile. Përveç kësaj, lehtësuesi i programit ROMACTED i ndoqi këto çështje në gjykatë.

## MBROJTJA SOCIALE

- 18 romë u mbështetën në marrjen e dokumenteve të nevojshme dhe në plotësimin e kriterëve mjekësore për përcaktimin e aftësisë për punë të personave me aftësi të kufizuara (Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë- KMCA). Anëtarët e GKV-së identifikuan rastet dhe ia referuan ato lehtësuesve të programit. Lehtësuesit ndihmuan më tej duke ndjekur procedurat për marrjen e lejes së punës;
- 98 romë morën mbështetje për t'u regjistruar për ndihmën social-ekonomike nga bashkia, në kuadrin e ndihmës për familjet në nevojë dhe për pagesën e papunësisë;
- Tre persona në nevojë u pajisën me karrige me rrota.




## INFRASTRUKTURA

- Në bashkëpunim me Njësinë Administrative të Dërmena: fshatin Baltëz, u caktua si tokë për përdorim si varrezë. Fshati (Bashkia Fier), një tokë në procedurat e blerjes u ndoan nga Bashkia Fier;
- U zëvendësuan koshat e plehrave në lagjet Drizë, Levan dhe Baltëz të romëve nga Bashkia Fier, pas përpjekjeve avokuese të lehtësuesve ROMACTED;
- U rindërtuan rrugët e brendshme të lagjes rome Fermë Çlirim.



## FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE DHE UJË



- U ul tarifa mujore e energjisë elektrike nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për 65 familje rome, të cilat janë debitorë për shërbimin e furnizimit me energji elektrike dhe përfituese të ndihmës ekonomike (mbështetjes sociale);
- 150 familje rome kanë akses në ujë të rrjedhshëm në Mbrostar pas instalimit të katër çezmave publike nga Drejtoria e Ujësjellës-kanalizimeve të Bashkisë Fier dhe kërkesave të Komisionerit për Mbrojtje nga Diskriminimi.

## NDIHMJA NË KUADRIN E EMERGJENCËS SË SHKAKTUAR NGA COVID-19

- U shpërndanë fletëpalosje informuese në gjuhën shqipe, rome dhe në gjuhën angleze në komunitetet rome gjatë shpërthimit të pandemisë së COVID-19;
- U hartuan lista të familjeve dhe të moshuarve romë në Fier që kishin nevojë për mbështetje urgjente;
- Kryetari të Bashkisë dhe Grupit Institucional të Punës iu drejtua një kërkesë për nevojat urgjente të romëve në Fier me shpërthimin e pandemisë COVID-19;
- U ofruan 167 paketa ushqimore emergjence në tre lagje rome për: 97 familje në Levan; 34 familje në Sektor Seman dhe 36 familje në Fermë Çlirimi.



# Strukturat e Programit

GRUPI KOMUNITAR I VEPRIMIT (GVK)  
GRUPIT INSTITUCIONAL TË PUNËS (GIP)  
GRUPIT TË TASK FORCËS SË BASHKISË (TFB)



## GRUPIT KOMUNITAR TË VEPRIMIT (GVK)



Duke pasur parasysh se Fieri është një bashki e madhe, që përfshin gjashtë lagje rome, u ngrit një GKV në secilën lagje me mesatarisht dhjetë anëtarë. U ngrit edhe një GKV në nivel bashkie për përfaqësimin e nën-GKV-ve, e përbërë nga 10-12 anëtarë, nga të cilët 6-7 janë gra. Këto GKV përbëhen nga qytetarë të grupmoshave dhe statuseve të ndryshme sociale, duke përfshirë liderë komuniteti dhe persona të besuar nga komuniteti dhe me reputacion të mirë. Takimet e GKV-ve zhvillohen çdo dy muaj për të diskutuar problemet më urgjente dhe për të gjetur zgjidhje. Nga prilli 2018 deri në mars 2020 janë zhvilluar 36 takime të GKV-ve me 534 romë (227 gra).  
ve me 534 romë (227 gra).

## GRUPIT INSTITUCIONAL TË PUNËS (GIP) GRUPIT INSTITUCIONAL TË PUNËS (GIP)



Takimet e GIP organizohen në bazë të problemeve më të ngutshme të anëtarëve të GKV-ve, si punësimi, shëndetësia, strehimi, arsimit, etj. Në këto takime marrin pjesë drejtuesit dhe specialistët e secilës fushë dhe përfaqësuesit e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale. Numri mesatar i pjesëmarrësve është pesë (tre gra) dhe takimet zhvillohen çdo muaj. Në total, nga prilli 2018 deri në mars 2020 janë zhvilluar 22 takime të GIP me 128 përfaqësues të autoriteteve vendore.

## GRUPIT TË TASK FORCËS SË BASHKISË (TFB)



Grupi i Task Forcës së Bashkisë përbëhet nga pjesëmarrës të autoriteteve vendore dhe nga anëtarë të GKV-ve. Numri i pjesëmarrësve varet nga tema e takimit, por mesatarisht janë pesë pjesëmarrës nga autoritetet vendore (Bashkia Fier, Njësitë Administrative, Zyra e Punës, Drejtoria e Arsimit dhe Shërbimet Sociale Shtetërore) dhe 6-10 pjesëmarrës nga anëtarët e GKV-ve. Këto takime zhvillohen dy herë në muaj. Në total, deri tani janë zhvilluar 65 takime të GTB me rreth 954 pjesëmarrës romë dhe jo romë.

# Dokumente Strategjike Vendore

## Plani Vendor i Veprimit

Plani Vendor i Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane është përgatitur në partneritet me Bashkinë Fier përmes një qasjeje me pjesëmarrje dhe konsultimeve me të dyja këto grupe pakicash. Plani u miratua nga Këshilli i Bashkisë Fier, Vendimi nr. 73, datë 18 qershor 2019.

# Projekte

Të zhvilluara në kuadër dhe/ose financiar prej programit

- Përmirësimi i shkollës fillore "Trifon Prifti" përmes skemës së granteve të vogla të ROMACTED;
- Janë zbatuar dy nisma të vogla në shkallë komuniteti, konkretisht u siguruan 20 karrige për kopshtin "Halit Gremi" në Mbrostar dhe 20 karrige dhe 3 tavolina për shkollën "Trifon Prifti", mbështetur me marrëveshjen e grantit të Institutit të Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA) si organizatë mbështetëse.

## Sinergjitë

E krijuara në nivel vendor

- Sinergjitë me organizatat vendore të shoqërisë civile: Së Bashku për Integrimin e Komunitetit Rom, Qendra Sociale Murialdo, Epoka e Re; Njerëzit të Parët, të cilat kanë kontribuar në përgatitjen e Planit Vendor të Veprimit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane;
- Koordinimi me Nismën për Ndryshim Social ARSIS, ku u siguruan çanta shkolle për nëntë fëmijë të klasës së 9-të në Sektor Seman;
- Sinergji të vazhdueshme me institucionet vendore, të cilat janë pjesë e Grupit të Task Forcës së Bashkisë në Bashkinë Fier

## Kontaktet

Kryetari i Bashkisë Fier: Z. Armando SUBASHI

Pika e Kontaktit të Bashkisë: Z. Agron MARGILAJ

Lehtësuesit ROMACTED: Z. Ermelind MALKO dhe Z. Eduart KOCI

